

Planifikimi i parisë

Paraja është një letër me vlerë e cila shërben për të blerë gjësende të ndryshme. Ajo mund të jetë në formë të letres dhe në formë të monedhës. Paraja, fitohet duke punuar, duke i shitur gjërat që nuk ju nevojiten apo duke i ruajtur ato që ua japin prindërit si dhuratë.

A e keni bërë plan se çfarë do t'i bleni shokut apo shoqes tuaj për ditëlindje?

A do të ju duhen paratë për këtë dhuratë?

Atëherë planifikimi i parisë është shumë i rëndësishëm. Së pari, ju duhet të planifikoni se sa kohë ju duhet për të mbledhur paratë e nevojshme. Pasi të caktoni kohën e nevojshme, ju duhet të filloni të kurseni ose të mbledhni para.

Profesionet e ndryshme

A keni menduar se çfarë do të bëheni kur të rriteni?

A e dini se profesionet e ndryshme nuk paguhen njësoj?



Për shembull, një avokat paguhet më shumë se një mësues. Ose, një mjek zakonisht paguhet më shumë se shoferi i autobusit.



Pra, kur të vendosni për profesionin e së ardhmes, ju duhet të shikoni se sa paguheni për secilin profesion. Në shumicën e rasteve, profesionet më të paguara kërkojnë më shumë shkollim prandaj është i rëndësishëm edukimi juaj.



UNË DHE PARAJA



"Ky projekt u financua përmes grantit të Ambasadës Amerikane në Prishtinë. Mendimet, përfundimet dhe konkludimet apo rekomandimet e shprehura këtu janë të Autorit(ëve) dhe jo medoemos pasqyrojnë qëndrimet e Departamentit të Shtetit."



Qendra për studime të avancuara
Center for advanced studies

Email: info@fit-ks.org
Website: www.fit-ks.org

Kursimi i Parasë

Kursimi i Parasë do të thotë që paratë nuk shpenzohen të gjitha, por një sasi e caktuar ruhet për t'u shpenzuar më vonë. Shumë njerëz i kursejnë paratë duke i dërguar në bankë, në mënyrë që t'i marrin kur kanë nevojë.

Banka

Banka është vendi ku mbahen dhe ruhen paratë e njerëzve. Gjithashtu, banka i ndihmon njerëzve që kanë nevojë për para duke iu huazuar para për një kohë të caktuar.

Llogaria Bankare

Llogaria Bankare është një ditari të cilën banka e mban për secilin klient. Aty tregohet se sa para keni dhe janë të dhënat tuaja personale. Mund të futni para në llogari dhe t'i merrni kur të ju nevojiten. Gjithashtu, nëse vendosni t'i ruani paratë në bankë, banka ju paguan interes.

Interesi

Interesi është shuma e parasë që banka ju paguan vetëm sepse keni ruajtur para. Sa më shumë para që ruani dhe sa më gjatë që i mbani në bankë, aq më shumë do të fitoni interes – para ekstra.



Si funksionon interesi?

Banka ua huazon njerëzve paratë që ata të kenë mundësi të blejnë gjëra të mëdha: për shembull, veturë apo shtëpi. Pas një kohe të caktuar këta persona duhet që t'i kthejnë paratë në bankë, por me një shumë pak më të madhe. Kjo shumë ekstra e paguar është sikur një falenderim për bankën që ua ka huazuar paratë. Këto para ekstra të paguara quhen interes.

Banka gjithashtu paguan interes për paratë që ju i mbani në bankë, ngaqë i'a keni mundësuar që të përdor paratë tuaja. Kështu, ju po paguheni vetëm sepse po ruani para.

Pra juve ju paguhet interes vetëm pse po ruani para, ndërsa ju paguani interes vetëm pse keni huazuar para nga banka. Interesante!

5 gjëra që ju duhet t'i bëni

- ✓ Kuptoni definicionin e parasë
- ✓ Planifikoni se si do t'i hargjoni paratë
- ✓ Hapni një llogari bankare për të kursyer paratë
- ✓ Mësoni se si funksionojnë bankat
- ✓ Mendoni rreth profesionit tuaj në të ardhmen



Hmm...

po mësoj për planifikimin dhe kursimin e parave

